



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANEL NR:1

NR I VENDIMIT: KPCC/D/A/120/2011
DATA E VENDIMIT: 07/09/2011

Komisionerë Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

ORDER

- (1) Në secilën nga tre (3) kërkesat e referuara në pjesën A të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që paraqitësi i kërkesës ka vërtetuar të drejtën pronësore për pronën e kërkuar ashtu si përcaktohet në vendimin individual përkatës.
- (2) Në secilën prej tre (3) kërkesave të përmendura në pjesën A të listës së bashkangjitur, Komisioni urdhëron që :
 - (a) Paraqitësit të kërkesës t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;
 - (b) Çdo person i cili ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri; dhe
 - (c) Nëse çdo person që ka uzurpuar pronën, i cili dështon të përmbushë urdhrin për lirimin e pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona; dhe
- (3) Në secilën prej njëmbëdhjetë (11) kërkesave të identifikuara në pjesët B dhe D të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë.
- (4) Në secilën prej shtatëdhjetë (70) kërkesave të identifikuara në pjesët C dhe E të listës së bashkangjitur Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079).

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Anekset e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Anekset e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e katërt nga 5 deri 7 shtator 2011 në Prishtinë. Gjithsej i janë paraqitur Komisionit 2,499 kërkesa për pronë bujqësore në seancën e njëzetë e katërt, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Dy kërkesa për pronë bujqësore të cilat iu paraqitën Komisionit nga Sekretaria Ekzekutive iu kthyen Sekretarisë nga Komisioni për verifikim të mëtejshëm dhe tridhjetë e katër kërkesa u tërhoqën nga Sekretaria Ekzekutive gjatë seancës. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e tre kërkesave në pritje të mbajtjes së seancës degjimore. Gjithsej 2,460 kërkesa për prone bujqësore u zgjodhën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim.

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim përfshin gjithsej 84 kërkesa ashtu si janë identifikuar në listën e bashkangjitur, Pjesa e mbetur prej 2,376 kërkesash për pronë bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës përfshihen në dy vendimet e tjera, pikërisht vendimet KPCC/D/A/119/2011 dhe KPCC/D/A/121/2011.

9. Gjithsej 72 nga 84 kërkesa të përfshira në këtë vendim nuk janë shqyrtuar më parë nga Komisioni, ndërsa dymbëdhjetë kërkesa (kërkesat nr. 06142, 06147, 06149, 06158, 06161, 06166, 30830, 30834, 30835, 30836, 31471 dhe 31476) ishin subjekt i një vendimi të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimi i mëparshëm në këto vendime është shfuqizuar nga Komisioni ose për shkak të notifikimit të pasaktë të pronave të kërkuara gjatë përpunimit të kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive ose për shkak të gabimeve të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë identifikuar pasi është marrë vendimi. Për rrjedhojë, këto kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar dhe korrigjimit të gabimeve të përpunimit. Dëshmitë dhe informacioni i ofruar nga palët përgjegjëse në kërkesë ose uzurpuesit aktuale të pronave të kërkuara është marrë në konsideratë nga Komisioni në procesin e rivendosjes së kërkesave. Në kërkesat për të cilat vendimet e mëparshme janë shfuqizuar nga Komisioni, Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar paraqitësit të kërkesës duke e informuar ata për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar se kërkesa do të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës të kërkuar. Paraqitësit e kërkesës si dhe autoritetet kadastrave përkatëse janë informuar se vendimet e mëparshme të Komisionit janë pavlerë dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor.

10. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të

që të tri Aneksat e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksat I, II dhe III, respektivisht.

drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

11. Të 74 kërkesat e shënuara në pjesët A, D dhe E të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose një pale që ka shprehur interes ligjor në këto prona ("pala përgjegjëse") e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079. Në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, secilës prej palëve përgjegjëse i është dorëzuar një kopje e kërkesës të parashtruar nga paraqitësi përkatës i kërkesës. Në bazë të nenit 3.5 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësve të kërkesave u është dorëzuar një kopje e dokumenteve të parashtruara nga palët respektive përgjegjëse në kërkesë. Të dy palëve, në secilën rast, u është dhënë mundësia të komentojnë për informacionin e ofruar nga pala tjetër, edhe komentet apo informacioni i tillë është marrë në konsideratë gjatë përpunimit dhe vendosjes të kërkesës.

12. Dhjetë kërkesat e shënuara në pjesën B dhe C të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sekretaria Ekzekutive ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme duke përfshirë notifikimin fizik të pronës, dhe/ose me anë të notifikimit të pronës përmes publikimit në gazeta zyrtare dhe gazeta, përmes autoriteteve vendore komunale, gjykatave vendore, udhëheqësve vendorë në fshat dhe institucioneve përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informacionet e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

B. Kërkesat nr. 11650 dhe 13826.

13. Kërkesat nr. 11650 dhe 13826 janë parashtruar nga dy paraqitës të ndryshëm të kërkesave në lidhje me të njëjtën pronë. Paraqitësi i kërkesës në kërkesën nr. 11650 ("Paraqitës i parë i kërkesës") e ka parashtruar kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore ndërsa paraqitësi i kërkesës në kërkesën nr. 13826 ("paraqitësi i dytë i kërkesës") pretendon të jetë bartës i së drejtës pronësore. Të dy paraqitësit e kërkesave i kontestojnë të drejtat e pohuara pronësore të njëri tjetrit.

14. Paraqitësi i parë i kërkesës parashtrroi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të babait të tij Serif Kurtisaj. Paraqitësi i parë i kërkesës pretendon se prona e kërkuar i takonte gjyshit të tij deri në vitin 1938 kur pronësia iu dha familjes së paraqitësit të dytë të kërkesës me vendim të Gjykatës Supreme të Shkupit. Paraqitësi i parë i kërkesës pohon gjithashtu se gjatë viteve 1990, familja Nikolic ushtroi tryzni ndaj paraqitësit të parë të kërkesës për ta blerë përsëri pronën duke kërcënuar se do t'ia shiste atë një personi tjetër. Me

tej paraqitësi i kërkesës deklaroi se familja e tij e ka konsideruar çmimin e blerjes si shumë të lartë për kohën dhe transaksioni nuk është bërë.

15. Paraqitësi i dytë i kërkesës parashtroi kërkesën fillimisht në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të babait të tij Trajko Nikolic, bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore. Pas depozitimit të kërkesës dhe në bazë të procedurës së trashëgimisë, Paraqitësi i dytë i kërkesës u bë bashkëpronar me vëllezërit/motrat e tij me 1/5 pjesë ideale të pronës së kërkuar. Në mbështetje të pretendimeve të tij, ai parashtroi fletën poseduese në emër të babait të tij dhe vendimin e trashëgimisë date 22 nëntor 2010 i cili e tregon paraqitësin e dytë të kërkesës si bashkëpronar i pjesës ideale prej 1/5 për pronën e kërkuar. Të dy dokumentet janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

16. Paraqitësi i dytë i kërkesës pohoi se ai e humbi posedimin e pronave të kërkuara për shkak të konfliktit, ndërsa Paraqitësi i parë i kërkesës pretendon se gjyshi i tij e humbi posedimin në vitin 1938 dhe e rimori pronën në posedim vetëm pas konfliktit të vitit 1999. Të dytë paraqitësit e kërkesave deklarojnë se ata kanë rënë dakord në një parakontratë të blerjes gjatë viteve 1990 dhe se paraqitësi i parë i kërkesës nuk i ka përmbushur detyrimet kontraktore. Paraqitësi i parë i kërkesës deklaroi se ai e konsideron çmimin e kërkuar të blerjes si shumë të lartë.

17. Komisioni konstaton që paraqitësi i dytë i kërkesës, ka treguar se ai është bashkëpronar i pjesës ideale prej 1/5 të pronave kontestuese dhe se ai nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që e kanë zanafillën në konfliktin e vitit 1998-99. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruar nga paraqitësi i dytë i kërkesës duhet të miratohet.

18. Në lidhje me kërkesën e parashtruar nga Paraqitësi i parë i kërkesës, është e dukshme që humbja e pretenduar e posedimit nuk ndërlidhet me konfliktin e vitit 1998-99; në të vërtetë Paraqitësi i parë i kërkesës deklaroi se gjyshi i tij e humbi posedimin në vitin 1938. Rrjedhimisht, kërkesa e Paraqitësit të parë të kërkesës bie jashtë juridiksionit të Komisionit e duhet të hidhet poshtë.

C. Kërkesat nr. 26383, 31224, 4926 dhe 49278.

19. Në kërkesat nr. 26383 dhe 49267 në njërën anë si edhe në kërkesat 31224 dhe 49278 në anën tjetër, paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore për të njëjtat prona respektivisht. Në kërkesën nr. 26383 dhe 31224, paraqitësi i kërkesës ka parashtruar kërkesat në cilësinë anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht vajzës së bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, Branislav Jaric. Kërkesat nr. 49267 dhe 49278 janë parashtruar nga vëllai i Branislav Jaric në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht djalit të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, Dusan Jaric.

20. Paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 26383 dhe 31224 ka paraqitur një vendim trashëgimie datë 27 gusht 2007, i cili tregon se Branislav Jaric ka trashëguar parcelat e kërkuara, ndërsa paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 49267 dhe 49278, i cili është vëllai i Branislav Jaric, ka trashëguar parcela të ndryshme nga babi i tyre Dusan Jaric. Vendimi është verifikuar si i vlefshëm nga Sekretaria Ekzekutive. Vendimi është gjithashtu i formës së prerë, pasi palët përkatëse, Branislav Jaric dhe paraqitësi i kërkesave nr. 49267 dhe 49278, kanë hequr dorë nga e drejta e tyre për të bërë ankesë.

21. Rrjedhimisht, pasi provat dëshmojnë se pronat e kërkuara i takojnë Branislav Jaris, duhet të miratohet vendim për konfirmimin e të drejtave pronësore në dobi të mbajtësit të së drejtës pronësore Branislav Jaric për kërkesat nr. 26383 dhe 31224.

22. Nga ky vendim del se paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 49267 dhe 49278 ka dështuar të dëshmojë të drejtën pronësore dhe rrjedhimisht kërkesa e tij duhet të refuzohet në pajtim me nenin 8.6 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.

D. Kërkesa të hedhura poshtë.

23. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

24. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

25. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit).

26. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj mbi pronën e kërkuar.

27. Ndonëse Komisioni ka pikëpamjen se humbja e posedimit që ka ndodhur përtej periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të konsiderohet që ndërlidhet

drejtpërsëdrejti me, apo që është pasojë e konfliktit, varësisht nga rrethanat e rastit, ai duhet të konstatojë se ka disa dëshmi që tregojnë se humbja e posedimit përfshin rrethanat që janë pasojë e konfliktit.

1. Kërkesa nr. 00257

28. Në kërkesën nr. 00257, paraqitësi i kërkesës, i cili përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e pronës së kërkuar.

29. Pala përgjegjëse pretendon se ai e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 1976 dhe ka qenë në posedim të pronës që nga ajo kohë. Ai deklaron se ka depozituar dy padi në Gjykatën Komunale në Gjilan në gusht të vitit 2003 në lidhje me pronën e kërkuar, duke përfshirë njërën ku kërkon konfirmimin e pronësisë për pronën e kërkuar. Kërkesa e palës përgjegjëse u refuzua si e pabazuar nga Gjykata Komunale më 12 korrik 2011.

30. Në bazë të nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse ka filluar procedura gjyqësore në lidhje me kërkesën para 16 tetorit 2006, kur hyri në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50. Pasi procedura gjyqësore në lidhje me pronat e kërkuara ka filluar në vitin 2003, kërkesa nuk është në juridiksion të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

2. Kërkesa nr. 01021

31. Në kërkesën nr. 01021 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore dhe kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e pronës së kërkuar.

32. Paraqitësi i kërkesës pohon se e ka blerë pronën në vitin 1984. Ai deklaron se është larguar nga Kosova gjatë konfliktit të armatosur dhe shkoj në Maqedoni. Ai deklaroi se pas kthimit prona ishte uzurpuar nga pala përgjegjëse Paraqitësi i kërkesës depozitoi padi në Gjykatën Komunale në Viti në vitin 2005 në lidhje me pronën e kërkuar ku kërkonte konfirmimin e pronësisë për pronën e kërkuar. Procedura gjyqësore vazhdon që nga ajo kohë dhe janë marrë vendime të ndryshme përfshirë edhe atë të Gjykatës Supreme të Kosovës.

33. Në bazë të nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse ka filluar procedura gjyqësore në lidhje me kërkesën para 16 tetorit 2006, kur hyri në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50. Pasi procedura gjyqësore në lidhje me pronën e kërkuar ka filluar në vitin 2005, kërkesa nuk është në juridiksion të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

3. Kërkesa nr. 01081

34. Në kërkesën nr. 01081, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht djalit të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore.

35. Pala përgjegjëse depozitoi padi ku kërkon konfirmimin e pronësisë për pronën e kërkuar në Gjykatën Komunale në Gjilan në tetor 2005.

36. Në bazë të nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse ka filluar procedura gjyqësore në lidhje me kërkesën para 16 tetorit 2006, kur hyri në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50.

Pasi procedura gjyqësore në lidhje me pronën e kërkuar ka filluar në vitin 2005, kërkesa nuk është në juridiksion të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

4. *Kërkesa nr. 06220*

37 Kërkesa nr. 06220 u depozitua nga një përfaqësues i autorizuar i mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore.

38 Paraqitësi i kërkesës pohon se ai e humbi posedimin i pronës së kërkuar në qershor 1999, por ka dështuar të ofrojë ndonjë dëshmi ose edhe shpjegim për këtë fakt. Sekretaria Ekzekutive i kërkoj paraqitësit të kërkesë shumë here për të dhënë sqarim në lidhje me pohimin se si kishte humbur posedimin për shkak të konfliktit, megjithatë, paraqitësi i kërkesës refuzoi të marrë pjesë në proces apo të ofrojë ndonjë dëshmi. Rrjedhimisht, pasi paraqitësi i kërkesës dështoi të dëshmojë se e kishte humbur posedimin si rezultat konfliktit të vitit 1998-99, kërkesa duhet të hidhet poshtë për mungesë juridiksioni.

5. *Kërkesa nr. 10749*

39. Paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesën nr. 10749 në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka parashtuar gjithashtu një kërkesë tjetër, kërkesën nr. 46202, ku kërkon konfirmimin e pronësisë për të njëjtën prone si në kërkesën nr. 10749.

40. Kërkesa nr. 46202 është miratuar nga Komisioni me vendimin grupor KPCC/D/A/76/2010 date 16 qershor 2010. Komisioni konsideron se vendimi i mëparshëm për të njëjtën lëndë përbën *res judicata*, dhe rrjedhimisht kërkesa nr. 10749 duhet të hidhet poshtë.

6. *Kërkesat nr. 13473, 13474, 13475, 13476 dhe 13477*

41. Këto kërkesa janë parashtuar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se u largua nga Kosova me familjen e tij në vitin 1970 dhe u vendos në Beograd.

42. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se ai nuk e ka humbur posedimin e pronës për shkak të konfliktit në Kosovë në vitin 1998-1999. Rrjedhimisht kërkesa e paraqitësit të kërkesës bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

E. *Kërkesa të refuzuara*

43. Në bazë të nenit 8.6 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 Komisioni mund të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze. Kërkesat mund të refuzohen nga Komisioni nëse paraqitësi i kërkesës, ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, nuk kanë mundur të dëshmojnë interesin për drejtat e tyre pronësore dhe të shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

44. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni ka kompetencë për të vendosur kërkesat e së drejtës pronësore ose të shfrytëzimit për pronën e paluajtshme. Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të marrë në konsideratë çfarëdo prova të besueshme, të cilat ai i konsideron të rëndësishme për kërkesën, përfshirë dëshmitë e paraqitura nga ana e Sekretarisë Ekzekutive lidhur me besueshmërinë e të

dhënave publike. (Neni 6.2 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e plotësuar me Ligjin nr 03/L-079). Komisioni mund të kërkojë nga Sekretariati për të marrë më shumë informacion nga një palë, ose për të kryer hetime shtesë në lidhje me ndonjë kërkesë (neni 6,3 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e plotësuar me Ligjin nr 03/L-079). Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të drejtohet, por nuk është e detyruar nga rregullat e marrjes së dëshmive të aplikuara në gjykatat vendore në Kosovë (pika 6,1 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e plotësuar me Ligjin nr 03/L-079).

1. Tjetërsimi vullnetar –mungesa e së drejtës pronësore.

45. Në kërkesën nr. 44394 paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së tij. Gjatë një bisede telefonike me Sekretarinë Ekzekutive më 15 prill 2011, paraqitësi i kërkesës deklaroi se prona ishte shitur dhe se ai nuk ishte i interesuar në ndjekjen e kërkesës. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës nuk e tërhoqi kërkesën.

46. Në kërkesën nr. 00667 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht të bashkëpronarit. Megjithatë, më pas paraqitësi i kërkesës pranoi se e kishte shitur pronën e kërkuar tek një palë e tretë.

47. Në kërkesën nr. 31370 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht nipit/mbesës të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pretendon se ai e ka blerë pronën e kërkuar nga babai i paraqitësit të kërkesës në vitin 1997. Kur u ballafaqua me këtë pretendim, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se prona ishte shitur dhe tregoi se ai nuk ishte i interesuar në vazhdimin e kërkesës. Megjithatë, ai nuk a tërhoqi kërkesën.

48. Kërkesat nr. 52384 dhe 52386, në njëërën anë dhe kërkesat nr. 54931 dhe 54933, në anët tjetër, lidhen me të njëjtën pronë. Paraqitësi i kërkesës në kërkesat me nr. 52384 dhe 52386 e ka parashtruar kërkesën në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore dhe paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 54931 dhe 54933 ka paraqitur kërkesën në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëpronar i paraqitësit të kërkesës në kërkesat nr. 52384 dhe 52386. Të dy paraqitësit e kërkesave janë motër e vëlla. Megjithatë, me pas të dy paraqitësit e kërkesave pranuan se pronat janë shitur dhe ata nuk kanë interes në ndjekjen e kërkesave të tyre respektive. Te dy paraqitësit e kërkesave dështuan në tërheqjen e kërkesave.

49. Në kërkesën nr. 25769 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht djalit të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Megjithatë, me pas ai konfirmoi se prona ishte shitur dhe se ai nuk kishte interes në ndjekjen e kërkesës. Paraqitësi i kërkesës nuk e tërhoqi kërkesën.

50. Në kërkesën nr. 51770 paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortes. Megjithatë ai pranoi se prona ishte shitur, por nuk e tërhoqi kërkesën.

51. Në kërkesën nr. 25958 paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht mbesa. Megjithatë, me pas ajo konfirmoi se prona ishte shitur. Paraqitësi i kërkesës nuk e tërhoqi kërkesën.

52. Në kërkesën nr. 30509 paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesë në cilësinë anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se prona ishte shitur por ai nuk e tërhoqi kërkesën.

53. Në kërkesat me nr. 37064, 37065 dhe 37085 paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht si stërmbesa e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Megjithatë, ajo më pas konfirmoi se pronat ishin shitur, por nuk i tërhoqi kërkesat.

54. Në kërkesat me nr. 51762, 51766, 51768 dhe 51769 paraqitësi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht bashkëshortes së mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se pronat janë shitur. Megjithatë, ai nuk e tërhoqi kërkesat.

55. Në kërkesat me nr. 06140, 06142, 06143, 06147, 06149, 06153, 06156, 06158, 06161, 06162, 06166, 06167, 06169 dhe 06171, paraqitësi i kërkesës ka parashtruar kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai i kishte shitur pronat por nuk ishte i sigurt nëse të gjitha parcelat e kërkuara ishin përfshirë në shitje ose jo. Sekretaria Ekzekutive verifikoi *ex officio* në regjistrat kadastrale se ne të vërtetë pronat e kërkuara ishin shitur. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës nuk i tërhoqi kërkesat.

56. Në kërkesat me nr. 30830, 30834, 30835 dhe 30836 paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht bashkëshortit të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se pronat janë shitur. Megjithatë, ajo nuk i tërhoqi kërkesat.

57. Në kërkesat me nr. 52384 dhe 52386 paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse, e cila është uzurpuesi aktual i pronave të kërkuara, pretendon se babai i tij i ka blerë pronat në vitin 1972 nga Milojka Jovanovic, vëllai i paraqitësit të kërkesës. Pala përgjegjëse pohon se ka pasur pa u shqetësuar posedimin e pronave qysh atëherë, megjithatë, ndryshimi i pronësisë nuk është regjistruar në librat kadastralë pasi nuk është bërë ndarje fizike e parcelave të kërkuara. Gjatë një bisede telefonike me 2 gusht 2011 me Sekretarinë Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës konfirmoi shitjen e pronave nga vëllai i tij në vitin 1972. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës refuzoi të tërheqë kërkesat.

58. Në kërkesat me nr. 50193, 50194 dhe 50195 paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pranon se xhaxhai i tij ia ka shitur pronat uzurpuesit aktual në vitin 1988, megjithatë ai dështoi të tërheqë kërkesën.

59. Në kërkesat me nr. 07883, 07891 dhe 07895 paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se ai ia shiti pronat uzurpuesit aktual në vitin 2007, megjithatë ai nuk e tërhoqi kërkesën.

60. Në kërkesat me nr. 25501, 25502, 25503 dhe 25506 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Djali i paraqitësit të kërkesës, konfirmoi se babai i tij ia kishte shitur pronat uzurpuesit aktual në vitin 1985. Paraqitësi i kërkesës nuk i tërhoqi kërkesat.

61. Në kërkesën nr. 48151 paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesën në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në një bisedë telefonike me Sekretarinë Ekzekutive, paraqitësi i

kërkesës konfirmoi pretendimet e palës përgjegjëse se ai, pra paraqitësi i kërkesës ia ka shitur pronën për më tepër së para 40 viteve gjyshit të palës përgjegjëse. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës nuk e tërhoqi kërkesën.

62. Në kërkesat me nr. 38158, 38159, 38160, 38161 dhe 38162 paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht të gjyshit të tij. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës pranoi se gjyshi i tij ua kishte shitur pronat në vitin 1979 dhe 1983 uzurpuesve aktuale të cilët janë të dy palë përgjegjëse në këto kërkesa. Paraqitësi i kërkesës nuk i tërhoqi kërkesat.

63. Në kërkesën me nr. 54401 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Ajo konfirmoi pretendimet e uzurpuesve aktual se ajo e kishte shitur pronën atyre në vitin 1984. Megjithatë paraqitësi i kërkesës nuk e tërhoqi kërkesën.

64. Kërkesat nr. 06212, 06213, 06214, 06217, 06221 janë paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar i bartësit të pretenduar të së drejtë pronësore. Paraqitësi i kërkesës i ka konfirmuar pretendimet e palës përgjegjëse se ai ia ka shitur pronën palës përgjegjëse në vitin 1972. Sekretaria Ekzekutive ka kërkuar disa herë nga paraqitësi i kërkesës të ofrojë sqarim lidhur me pohimin se e ka humbur pronën si pasojë e konfliktit. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës ka refuzuar të marrë pjesë në proces apo të ofrojë dëshmi.

65. Në të gjitha kërkesat e përfshira ne seksionin E paraqitësit e kërkesave fillimisht pretenduan se ata ose familjet e tyre kishin humbur posedimin e pronave të kërkuara për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999. Megjithatë, më vonë, paraqitësi i kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se ata apo familjet e tyre, sipas rastit, i kishin tjetërsuar pronat vullnetarisht. Për rrjedhojë, kërkesat duhet të refuzohen nga Komisioni për shkak të dështimit të paraqitësve të kërkesave për të dëshmuar të drejtën pronësore aktuale për pronat e kërkuara.

2. Kërkesat nr. 15538, 15539, 15540, 15541, 15542, 15543, 15544 dhe 15545

66. Në kërkesat me nr. 15538, 15539, 15540, 15541, 15542, 15543, 15544 dhe 15545 paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht të vajzës së saj. Vajza e paraqitësit të kërkesës, Verica Babovic e informoi më pas Sekretarinë Ekzekutive se nëna e saj kishte vdekur pas parashtrimit të kërkesave.

67. Në kërkesat me nr. 15544 dhe 15545 paraqitësi i kërkesës nëna e saj kishte përfituar pronësinë për pronat e kërkuara edhe të tjerat në vitin 1964. Në mbështetje të pretendimeve të saj, paraqitësi i kërkesës parashtroi një kontratë shkëmbimi të datës 28 shtator 1964 me anë të secilës nëna e paraqitësit të kërkesës ia kishte transferuar pronësinë për dy pronat tek ndërmarrja "Poljoprivredno Dobro, Hvosno" në kthim të dy parcelave të kërkuara. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive, e pati të pamundur të vërtetojë vërtetësinë e këtij dokumenti. Më tej, Sekretaria Ekzekutive siguroi fletën poseduese të pronave të kërkuara *ex officio* dhe i konstatoi pronat në emër të një personi tjetër, pikërisht në emër të Mirka Racic-Kazic. Më pas vajza e paraqitëses së kërkesës pranoi se disa nga pronat ishin shitur tek një palë e tretë në vitin 1979, megjithatë ajo pretendon se transaksioni nuk përfshin dy parcelat e kërkuara.

68. Në kërkesat me nr . 15538, 15539, 15540, 15541, 15542 dhe 15543, Pala përgjegjëse pretendon se nena e paraqitësit të kërkesës i kishte shitur pronat tek pala përgjegjëse në vitin 1979. Më pas paraqitësi i kërkesës konfirmoi pretendimet e palës përgjegjëse.

69. Bazuar sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës në kërkesat me nr . 15538, 15539, 15540, 15541, 15542, 15543, 15544 dhe 15545 ka dështuar të dëshmojë pronësinë e pretenduesit të mbajtësit të së drejtës pronësore për pronat e kërkuara. Rrjedhimisht kërkesat duhet të hidhen poshtë.

3. Kërkesat nr. 31471 dhe 31478

70. Në kërkesat me nr. 31471 dhe 31478 paraqitësi i kërkesës pretendon se ai ka blerë pronat e pretenduara dhe parashtrori fletën poseduese në mbështetje të kërkesë së tij. Megjithatë, dokumenti nuk e tregon atë ose ndonjë nga anëtarët e bashkësisë familjare si pronar të pronave të kërkuara.

71. Paraqitësit të kërkesës iu kërkuar të ofrojnë një kopje të kontratës së blerjes dhe iu dha një afat për ta ofruar atë. Paraqitësi i kërkesës tregoi se do ta ofronte atë por nuk arriti ta paraqitë. Asnjë dëshmi tjetër nuk u ofrua nga paraqitësi i kërkesës ose nuk u gjet nga Sekretaria Ekzekutive që të tregonte se paraqitësi i kërkesës kishte gëzuar të drejtë pronësore ose në të vërtetë ndonjë të drejtë pronësore për pronën e kërkuar. Rrjedhimisht, në mungesë të dëshmive mbështetëse, paraqitësi i kërkesës dështoi të dëshmojë të drejtën pronësore për pronat e kërkuara dhe të dy kërkesat duhet të refuzohen.

F. Vërejtje përmbledhëse

72. Vendimi dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar banesore.

73. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.

74. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e paraqitësve të kërkesave ose mbajtësve të së drejtës pronësore, sipas rastit për të kërkuar konfirmimin e të drejtave pronësore për pronat e kërkuara, para autoriteteve vendore kompetente të tilla si organet kadastrale ose gjykatat vendore, në pajtim me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA13826
KPA26383
KPA31224

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA06220
KPA10749

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA44394
KPA54931
KPA54933
KPA00667
KPA25769
KPA31370
KPA49267
KPA49278

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part D/Pjesa D/Deo D

KPA11650
KPA00257
KPA01081
KPA13473
KPA13474
KPA13475
KPA13476
KPA13477
KPA01021

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part E/Pjesa E/Deo E

KPA51770	KPA25958	KPA30509	KPA37065	KPA37085	KPA51762	KPA51766
KPA51768	KPA51769	KPA06140	KPA06142	KPA06143	KPA06147	KPA06149
KPA06153	KPA06156	KPA06158	KPA06161	KPA06162	KPA06166	KPA06167
KPA06169	KPA06171	KPA30830	KPA30834	KPA30835	KPA52384	KPA52386
KPA06212	KPA06213	KPA06214	KPA06217	KPA06221	KPA30836	KPA15544
KPA15545	KPA37064	KPA50193	KPA50194	KPA50195	KPA07883	KPA07891
KPA07895	KPA25501	KPA25502	KPA25503	KPA25506	KPA48151	KPA15538
KPA15539	KPA15540	KPA15541	KPA15542	KPA15543	KPA38158	KPA38159
KPA38160	KPA38161	KPA38162	KPA54401	KPA31476	KPA31471	